

25.08.2021

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE  
“IMAKETech” SHPK**

**Neni 1  
Ortaku themelues**

- 1.1 Shoqëria “IMAKETech” SHPK themelohet nga Ortaku i Vetëm Znj. Anxhela Curri , atesia Ibrahim , amesia Majlinda , shtetase shqiptare , e datelindjes 02.10.1995 , lindur ne Kavaje dhe banuese rr “Dibres” nd.6 , h.5 ap.41 Tirane , mbajtëse e leternjoftimit me nr.031725169 dhe nr.personal J56002101E .

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**Neni 2  
Emërtimi**

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është “IMAKETech” SHPK

**Neni 3  
Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.  
3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4  
Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

**Neni 5  
Kohëzgjatja e veprimitarisë**

- 5.1 Veprimitaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”).  
5.2 Afati i veprimitarisë së shoqërisë është per nje afat te pacaktuar

**Neni 6  
Selia**

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: rr “Dibres” nd.6 , h.5 ap.41 Tirane



- 6.2 Administratori i shoqërise mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/osc zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të rrregjistroje ato ekzistuese sipas ligjeve ne fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim te Administratorit te shoqërisë.

**Neni 7  
Objekti**

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: »**Kibernetik , Asistence dhe Konsultim kompjuterik, zhvillim / programimim ne WEB , kerkim i optimizuar ne WEB dhe marketing dixhital**« .
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 8  
Kapitali**

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10 000 (dhjete mijë) Leke.
- 9.2 Ortaku i Vetëm zoteron 1 (një) kuote, e cila eshte e barabarte me vleren e kapitalit.
- 9.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

**Neni 9  
Transferimi i kuotave. Kufizimet.**

- 10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Ortakut të Vetëm.

**Neni 10  
Rritja e kapitalit**

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 11  
Zvogëlimi i kapitalit**

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislationi tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do t'i shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin ortakut të vetëm raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë.

## ORGANET E SHOQËRISË

### **Neni 12 Vendimet e ortakut të vetëm**

13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm i saj.

13.2 Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kryesisht:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe percaktimin e shpërblimit per ta;
- Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe percaktimin e shpërblimit per ta;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore      dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.

### **Neni 13 Administrimi**

14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Ortakut të Vetëm.

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm. Administratori i shoqërisë eshte **Znj. Anxhela Curri , atesa Ibrahim , amesa Majlinda , shtetase shqiptare , e datelindjes 02.10.1995 , lindur ne Kavaje dhe banuese rr "Dibres" nd.6 , h.5 ap.41 Tirane .**

14.3 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
- Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëni me të tretë personalisht ose me përfaqësim;
- Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
- Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, institucione apo entitete publike ose private;



- Të lidhë për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
- Të punësojë dhc pushojë punëmarrës apo staf tjeter që konsiderohet i nevojshëm përmbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri;
- Të vndos për ndryshimin e selisë së shoqërisë;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përparrë bankave të nivelistë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- Të ndërmarrë çdo veprimtari tjeter ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm përmbarëvajtjen e shoqërisë në Shqipëri.

14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm përmes 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Ortakut të Vetëm.

#### **Neni 14 Viti finansiar**

- 15.1 Viti finansiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë finansiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

#### **Neni 15 Bilanci. Kontabiliteti.**

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet përmes paraqitur para organeve tatumore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkessave të legjislativit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

#### **Neni 16 Te Ardhurat. Dividendi**

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë përmes realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përpunim me kërkusat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtarc".
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund t'i kalojnë ortakut te vetem.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortaku do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

**Neni 17**  
**Likuidimi**

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Ortakut të Vetëm.
- 18.2 Me vendimin e Ortakut të Vetëm caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedurë, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

**Neni 18**  
**Mosmarrëveshjet**

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtronen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

**Neni 19**  
**Klauzolë mbyllëse**

- 20.1 Ky Statut hartoheq në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

**“IMAKETech” SHPK**

*Ortaku i Vetëm:*

**Anxhela Curri**

